

VENDIM
Nr. 906, datë 21.12.2016

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË
PYJORE “MALI I MOLISHTIT”, TË RRETHIT BERAT,
QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “SALILLARI” SHPK PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETIT MINERAR NË SHFRYTËZIMIN E MINERALIT
TË GURIT GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 16.2 ha, në ngastrat 172a, 173a, 174a dhe 175a, të ekonomisë pyjore “Mali i Molishtit”, objekt i aktivitetit minerar për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror nga shoqëria “Salillari” sh.p.k., të hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Sipërfaqja, sipas ngastrave pyjore dhe kullosore, jepet në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të produkteve të tjera pyjore e jopyjore, të sipërfaqes së hequr dhe infrastrukturës së saj, paguhet nga subjekti “Salillari” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Salillari” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në shfrytëzim sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 5 viteve të para, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 48.6 ha fond pyjor në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me bashkinë Ura Vajgurore.

4. Bashkia Ura Vajgurore dhe shoqëria “Salillari” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin dhe realizimin e projekteve teknike lidhur me detyrimet sipas pikës 3, të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në funksion të lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë “Salillari” sh.p.k.

6. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqeve pyjore të identifikuara sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë pyjore/kullosore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Salillari” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet fond pyjor dhe kullosor.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, bashkia Ura Vajgurore dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN
 NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
 MINERAR NGA SHOQËRIA "SALILLARI" sh.p.k. në rrethin e BERATIT

QARKU BERAT

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
BR 27 172a	Mali I Molishtit	172 a	Ministria Mjedisit	3.6
BR 27 173a	Mali I Molishtit	173 a	Ministria Mjedisit	5.9
BR 27 174a	Mali I Molishtit	174 a	Ministria Mjedisit	2.4
BR 27 175a	Mali I Molishtit	175 a	Ministria Mjedisit	4.3
GJITHSEJ				16.20